



Analizë e raporteve vjetore



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK

DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

Raporti vjetor i Autoritetit të Aviacionit Civil 2017

“Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.”

Raporti vjetor i Autoritetit të Aviacionit Civil 2017

Analizë 04/2017

Instituti për Politika Zhvillimore në kuadër të punës mbështetëse për Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, ka shqyrtuar dhe analizuar raportin vjetor të AAC për vitin 2017. Kjo analizë përkon me preokupimin e vazhdueshëm të INDEP me çështjen e agjencive të pavarura dhe instrumenteve mbikëqyrëse së punës së tyre, kështu duke e cilësuar transparencën dhe llogaridhënien si faktorë kyçë në funksionimin e tyre.

Të gjeturat e raportit

Një nga karakteristikat e raporteve vjetore të Autoritetit të Aviacionit Civil në vazhdimësi mbetet përdorimi i raportit vjetor si promovues i agjencisë. Përmes theksimit të takimeve protokollare me institucione tjera dhe minimizimit të përgjegjësisë dhe llogaridhënies ndaj detyrave të përcaktuara ligjërish, kjo agjenci dështon ta përdorë raportin vjetor si mjet përmes të cilit do të avokonte për mbështetje institucionale për funksionalizimin e kësaj agjencie.

Raportit i mungojnë të dhëna specifike që do të tregonin për punën e AAC-së gjatë vitit 2017; të cilat do t'i jepnin një pasqyrë të qartë publikut mbi vështirësitë, sfidat apo edhe progresin e bërë të kësaj agjencie. Ngjashëm, as këtë vit në raport nuk përfshihen ngjarjet e raportuara nga mediet për mungesën e një gjeneratori të dytë dhe shkaktimin e një avarie. AAC-ja vazhdon që pjesës së raportimit të incidenteve t'ia kushtojë vetëm një faqe me një tabelë të inkuadruar, e çka në fakt do të duhej të ishte pikërisht fokusi i raportit. INDEP vlerëson se ky raport përmban informata të shumta jo relevante për aktivitetin e tyre të përgjithshëm, të cilat e bëjnë raportin substancialisht të varfër.

- **Organizimi**

Ndonëse AAC-ja jep informacione të mjaftueshme për stafin; krahasuar me vitin e kaluar kur kishte kërkuar staf shtesë 27 në 37, në raportin e sivjemë nuk e paraqet të njëjtën çështje ndonëse ende funksionon me pothuajse të njëjtin numër të punëtorëve. Megjithatë, vetëm më vonë në raport e risjell në vëmendje se AAC-së nuk po i mundësohet rekrutimi i stafit të nevojshëm teknik, të cilin sipas AAC-së, ajo po e humbë dhe kjo paraqet brengë të vazhdueshme për funksionimin e AAC-së. INDEP vlerëson se një çështje e rëndësishme së tillë duhet të figurojë më lartë në raport nëse agjencia e AC e vlerëson kruciale këtë çështje, pasi raporti vjetor mund të shërbejë edhe si evokim i vazhdueshëm tek institucionet përkatëse për përmbushjen e nevojave të agjencive të pavarura.

AAC ka një Zëvendës Drejtor i cili nuk është i paraparë me Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil të Republikës së Kosovës. AAC do të udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i Aviacionit Civil ("Drejtori i Përgjithshëm") i cili punon me orar të plotë. Drejtori i Përgjithshëm është zyrtari

i AAC-së i cili është përgjegjës për menaxhimin e përditshëm dhe vendimmarrjen në AAC.¹ Të gjitha kompetencat në udhëheqjen e Autoritetit i ka Drejtori në bazë të ligjit dhe AAC të paktën ligjërisht nuk parashihet që të ketë Zëvendësdrejtor. Sidoqoftë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka zgjedhur në janar të vitit 2017 Zëvendësdrejtorin² duke u bazuar në nenin 6.3 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil i cili flet për kompetencat e Ministrit por që askund nuk i referohet organizimit të brendshëm të AAC-së dhe nenit 14.3.

AAC do të ketë personelin e nevojshëm profesional dhe administrativ i cili është i nevojshëm për të mundur AAC-së dhe Drejtorit të Përgjithshëm zbatimin e funksioneve dhe përgjegjësi që u janë dhënë atyre me këtë ligj.³

Neni në fjalë vetëm e komplementon nenin 25 mbi përgatitjen e buxhetit dhe se si në bazë të nevojave Drejtori do të bëjë kërkesën buxhetore gjithnjë duke plotësuar nevojat për personel profesional dhe administrativ, jo edhe udhëheqës. Për INDEP, nevoja për zëvendësdrejtor dhe zgjedhja e zëvendësdrejtorit të tanishëm është ligjërisht e kontestueshme.

- **Buxheti**

Buxheti për vitin 2017 ka qenë i shkurtuar, AAC-ja nuk ka dhënë informata se si dhe në çka specifikisht ka ndikuar shkurtimi i buxhetit në funksionimin e tërësishëm të kësaj agjencie, megjithëse edhe më vonë në raport theksohet se mungesa e buxhetit të mjaftueshëm po e cenon AAC-në në trajnimet e nevojshme për punëtorë.

- **Funksionalizimi i bordit**

Në anën tjetër, raporti përfshin të dhëna për emërimin e bordit mbikëqyrës dhe mandatin e tyre, por raporti nuk tregon se çfarë ndikimi ka pasur funksionalizimi i bordit pas dy viteve mungesë. INDEP vlerëson që raporti duhet të japë krahasime të funksionimit të AAC-së të viteve paraprake në mungesë të bordit me vitin 2016 kur ky bord është funksionalizuar.

- **Siguria në aviacion**

AAC, ndër tjerash, nën kornizën e saj ligjore që shërben si përcaktuese e kompetencave të saj, është e obliguar ta bëjë rregullimin e sigurisë së transportit ajror në Republikën e Kosovës. Në raport thuhet se “Me qëllim të ngritjes së sigurisë në aviacion duke parandaluar aksidentet dhe incidentet, AAC-ja menaxhon sistemin e raportimit të ndodhive në aviacionin civil, përmes së cilit mbledh informacione relevante për sigurinë e aviacionit civil, bën procesimin e tyre, hetimin, analizimin, ruajtjen, shkëmbimin dhe shpërndarjen e tyre, duke përjashtuar atribuimin e fajit apo përgjegjësisë.”

¹ Republika e Kosovës, (2008), Ligji Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, Kreu III – Autoriteti i Aviacionit Civil në Republikën e Kosovës, Neni 14.2, Prishtinë: GZRKS.

² Qeveria e Republikës së Kosovës, (2017), Vendim Nr. 03/129 për Emërimin e Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, Prishtinë: ZKM, i qasshëm në http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_129-te_te_Qeverise.pdf (qasur në prill, 2018)

³ Ibid, Neni 14.3.

Megjithkëtë raporti jep të dhëna sipërfaqësore mbi ndodhitë në aviacion gjatë vitit 2017 – ku përfshihet, ndër tjerash, futja e qenve dhe shpendëve në ANP – AAC në këtë mënyrë shmang shpjegimet rreth raportimeve të medieve për mungesën e një gjeneratori të dytë rezervë që vlerësohet të paraqesë rrezik serioz, si dhe nga shqetësimet e tjera të ngritura nga EUOCI-së si prishjet e rrezikshme me pasoja serioze të sigurisë, si prishja radarëve dhe pjesëve rezervë të komunikimit. Hetuesit e Zyrës së Bashkimit Evropian për Inteligjencë Kriminale në raportin e tyre për Aeroportin e Prishtinës të përgatitur për EULEX-in, thotë se thyerja e protokolleve të sigurisë me prishje radarësh e mungesë gjeneratorësh janë vetëm një anë e problemeve, derisa ngrenë dyshime për keqpërdorime financiare në projekte milionëshe.

Një tjetër ndodhi e raportuar nga mediet ishte edhe dështimi i sistemit të sigurisë në Aeroportin e Prishtinës dhe në ASHNA gjatë një testi të kryer nga Ministria e Punëve të Brendshme.⁴ Dy persona të armatosur kanë arritur t'i kalojnë të gjitha sistemet e sigurisë pa u detektuar as nga mekanizmat e Aeroportit të Prishtinës e as nga ata të ASHNA-s, por kjo ndodhi nuk përmendet as kalimthi në raportin e AAC-së, ani pse është autoritet mbikëqyrës i ASHNA-s.

Po ashtu, AAC-ja do të duhej t'i adresonte shqetësimet e ngritura nga mediet, edhe në mos qofshin të vërteta, së paku të ofrojë argumente dhe fakte se nuk ka vend për shqetësim. AAC-ja do të duhej që në këtë raport vjetor së paku t'i adresonte këto dy çështje:

- **Si janë trajtuar shqetësimet e ngritura nga EUOCI si prishjet e radarëve dhe mungesa e gjeneratorit rezervë**
- **Si është trajtuar dyshimi i ngritur për keqpërdorime financiare në projekte milionëshe, ku si i dyshuar përmendet drejtori i ASHNA-s**
- **Si është trajtuar dështimi i sistemeve të sigurisë të ANP-së dhe ASHNA-s nga ana e AAC-së**

Ndërkaq, gjatë raportimin mbi mbikëqyrjen e ASHNA-s thuhet se gjatë auditimit në shkurt 2017“... u hapën gjithsej 25 gjetje të reja, ndërsa është mbyllur një nga gjetjet e mëparshme”, ndërkaq gjatë auditimit në muajin shtator në ASHNA, thuhet të mos jetë hapur ndonjë gjetje e re, por se “... departamenti i SHNA-së ka përgatitur një raport i cili përmbledh të gjeturat nga ky auditim të cilin e ka përcjell te ASHNA.”. AAC duhet ta përdorë raportin vjetor për të treguar edhe se cilat kanë qenë gjetjet pas secilit auditim dhe cilat kanë qenë masat e propozuara nga ASHNA për adresimin e gjetjeve të identifikuar. Po ashtu, është e nevojshme të raportohet edhe për nivelin e rëndësisë së gjetjeve. Kjo do të shërbente edhe si tregues se me çfarë sfidash përballet ASHNA dhe si qëndron në përpjekjet e saj për t'i adresuar ato.

⁴ Portali Koha.net (29 nëntor, 2017), Detaje të reja rreth dështimit të sigurisë në Aeroportin e Prishtinës, i qasshëm në <https://www.koha.net/arberi/60378/detaje-te-reja-rreth-deshtimit-te-sigurise-ne-aeroportin-e-prishtines/> (qasur në prill, 2018).

Në këtë kuptim, në këtë raport vihet re që numri i ndodhive është rritur krahasuar me vitin 2015 – 2016. **Nga 130 – 132 ndodhi gjatë këtyre viteve, gjatë 2017, numri është rritur në 149.** Shpjegimi i AAC-së se “rritja e lehtë e numrit të ndodhive në vitin 2017 nuk paraqet rënie të nivelit të sigurisë në avacionin civil, por mund të ketë ardhur si rezultat i raportimit më të përpiktë nga pjesëmarrësit në industrinë e aviacionit” si i tillë është i pamjaftueshëm.

- **Licencat**

Në bazë të Manualit, AAC-ja duhet të ofrojë statistika rreth licencave, certifikatave dhe lejeve të aprovuara, përfshirë pezullimet dhe revokimet e tyre. Në këtë raport vjetor të AAC-së, raportimi në këtë kategori është i mangët. INDEP vlerëson se AAC-ja duhet të japë të dhëna të hollësishme për licencat që i lëshon dhe ato që i refuzon. detaje të tjera, si p.sh sa prej kërkesave për licencim janë refuzuar si dhe arsyet për refuzimet potenciale. Në të njëjtën linjë, nuk ka ndonjë të dhënë për pezullimet dhe revokimet potenciale të licencave.

Përmbajtja e Raportit të Autoritetit të Aviacionit Civil					
Listë Kontrolluese					
		Po	Jo	N/A	Koment
<i>Forma e Përgjithshme e Raportit</i>					
1	Përmbledhje ekzekutive				
	a. Pikave kryesore të cilat elaborohen në raport	Po			
	b. Arritjet e agjencisë për vitin e raportimit	Po			
	c. Objektivat për vitin e ardhshëm		Jo		
2	Baza Ligjore, Permirosimet dhe Veshtiresite				
	a. Ligjet, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme të institucionit	Po			
3	Përshkrimi i Institucionit				
	a. Misioni / Vizioni dhe Kompetencat	Po			
	b. Departamente përgjegjëse për plotësimin e detyrave kryesore që i përkasin kompetencave	Po			
4	Organizmi institucional				
	a. Raportimi për organizimin e brendshëm të institucionit (bordi, ekzekutivi, deri te personeli)	Po			
	b. Puna e bordit gjatë vitit raportues	Po			
	c. Organogrami; Hapesira fizike dhe lokacionit; Deklarimi I mungeses se infrastruktures se nevojshme fizike	Po			Megjithëse më vonë në raport theksohet nevoja për staf shtesë dhe një zgjidhje për lokacion.
	d. Asetet	Po			
5	Përshkrim i Tregut/Fushën që e mbulon institucioni				
	a. Krahasimi i tregut për më se paku tri vitet paraprake dhe planeve për vitin vijues	Po			
	b. Çka ka ndërmarrë Institucioni që të përmirësohet/monitorohet tregu/fusha e veprimit				Deri në një masë.
	c. Sfidat e vitit paraprak dhe planifikimi për vitin vijues		Jo		

6	Puna gjatë vitit paraprak				
	a. Punet specifike që agjencia i ka bërë gjatë vitit raportues	Po			Një pjesë të madhe të raportit e zënë vizitat.
	b. Detyrat dhe përgjegjësitë konform ligjit		Jo		AAC dështon të japë përgjegjësi për dyshimet e ngritura nga mediet për sigurinë në ANP.
	c. Sa janë arritur qëllimet e parapara nga viti paraprak (te arsyetohen ato që nuk janë arritur)			N/A	
7	Raporti financiar				
	a. Raporti i buxhetit me shpenzime	Po			
	b. Të ndahen rrogat nga mëditjet	Po			
	c. Ndikimi i buxhetit në punën e Institutit	Po			Megjithëse jo në pjesën e buxhetit, por e elaboruar shkurtimisht tek sfidat.
	d. Planifikimi / Realizimi i buxhetit	Po			
	e. Investimet kapitale				Nuk ka pasur.
	f. Tabelë krahasuese me buxhetin e tri viteve paraprake	Po			Vetem me vitin paraprak
	g. Shpenzimet buxhetore në bazë të aktiviteteve	Po			
	h. Vizitat jashtë vendit, mëditje, akomodim, numri I udhëtimeve dhe personave që kanë marrë pjesë	Po			Vetem buxheti i shpenzuar për mëditje për vizita jashtë vendit, akomodim. Nuk ka të dhëna kush ka marrë pjesë as sa është numri i tyre
8	Raportimi rreth komenteve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm				
	a. Tabela duhet paraqitur me komentet dhe rekomandimet e ZAP dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre nga ana e institucionit		Jo		
9	Anekset				
	a. Të dhënat për vendimet dhe lëshimin e licencave	Po			
	b. Të dhëna shtesë për informatat e përgjithshme të shtjelluara në raport		Jo		

Specifikat e Raportimit

10	6.1.1. Këshillat dhe propozimet e ofruara nga AAC për Ministrinë, Qeverinë dhe Kuvendin lidhur me politikat dhe legjislacionin nga fusha e aviacionit civil.		Jo		
11	6.1.2. Statistika rreth licencave, certifikatave dhe lejevetë aprovuara, duke përfshirë pezullimet dhe revokimet e tyre.	Po			Nuk ka të dhëna për lejet e pezulluara apo revokimet e tyre.
12	6.1.3. Informatat e shpërndara për publikun rreth çështjeve relevante mbi funksionet dhe aktivitetet e AAC-së.	Po			
13	6.1.4. Avionët civil të regjistruar dhe ata të larguar nga Regjistri i Avionëve Civil.			N/A	
14	6.1.5. Inspektimet e kryera në platformë dhe kontrollimet në vend.	Po			
15	6.1.6. Bllokimet e Avionëve të Rrezikshëm.		Jo		
	6.1.7. Dispozitat ndëshkimore të shqiptuara.		Jo		

“Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”